Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2026/0732

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Kimete Gashi Brajshori Kryetare duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) "IMK BALLKAN PROJEKT" SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Shqyrtimet laboratorike për projektet e investive kapitale- projekt tre vjeqar me numër të prokurimit 622-26-1534-2-1-1, me 17/11/2026, mori:

Vendim

1. **Aprovohet**, si pjeserisht e bazuar ankesa e OE "IMK BALLKAN PROJEKT" SH.P.K. me nr. 2026/0732 , e datës 24/09/2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit Shqyrtimet laboratorike për projektet e investive kapitale- projekt tre vjeqar me numër të prokurimit 622-26-1534-2-1-1.

2. Vertetohet B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK të KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT, lidhur me aktivitetin e prokurimit Shqyrtimet laboratorike për projektet e investive kapitale- projekt tre vjeqar me numër të prokurimit 622-26-1534-2-1-1

3. L**ejohet** kthimi i tarifes së ankeses në shumen e deponuar ashtu që obligohet operatori ekonomik ankues që brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditëve pas pranimit të këtij vendimi të parashtroj kërkesë për kthimin e tarifës në përputhje me nenin 31 par. 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, nën paralajmërimin që nëse nuk parashtrohet kërkesa brenda afatit, do të bëhet konfiskimi i depozitës dhe të gjitha mjetet e deponuara do të kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 23.03.2026. “ KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Ftesën për ofertim, për aktivitetin e prokurimit “Shqyrtimet laboratorike per projektet e investive kapitale- projekt tre vjeqar” me nr. të prokurimit: "622-26-1534-2-1-1"

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 150,000.00 €.

Me 08.09.20206. KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar Njoftimin mbi vendimin (B58), kunder njoftimit për dhënje të kontrates ku është rekomanduar për kontratë "N.SH. TEST&ING".

Me 14.09.2026, OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim ku me datë 14.09.2026. AK e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 24.09.2026, OE "IMK BALLKAN PROJEKT" SH.P.K. ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 2026/0732, duke e atakuar Vendimin e cituar si më sipër të AK, kunder njoftimit për dhenje të kontratës.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "IMK BALLKAN PROJEKT" SH.P.K.janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi I (Menaxheri i Projektit / akreditimi DAK): Eksperti ka konstatuar se, sipas Ligjit Nr. 05/L-117 për Akreditim, DAK nuk parasheh akreditim personal dhe se akreditimi i dhënë OE ankues, me komplet stafin dhe pajisjet e plota, e plotëson këtë kriter – pretendimi i bazuar.

Pretendimi 2 (Certifikatat ISO): Eksperti ka konstatuar se OE ka ofruar certifikatat ISO 9001:2015, ISO 14001:2015 dhe ISO 45001:2018, siç kërkohen në dosjen e tenderit – pretendimi i qëndrueshëm.

Pretendimi 3 (Pajisje/teknike): Eksperti ka konstatuar se OE ka ofruar listën e nënshkruar/vulosur të pajisjeve, marrëveshje qiraje për mjetet që nuk i posedon, libreza regjistrimi dhe DUD/fatura – pretendimi i qëndrueshëm.

Paneli Shqyrtues, duke iu referuar nenit 104, paragrafi 1, dhe nenit 1 të LPP-së, ka urdhëruar shprehimisht AK-në që, gjatë rivlerësimit të këtij aktiviteti të prokurimit, t'i përmbahet në tërësi dispozitave ligjore të LPP-së.

Megjithatë, tani, pas rivlerësimit me njoftimin mbi vendimin (B58) të datës 08.09.2026, në zbatim të Vendimit të OSHP-së nr. 2026/0530, autoriteti kontraktues na ka eliminuar përsëri, duke e rekomanduar për kontratë po të njëjtin operator ekonomik, N.Sh. Test&Ing Suharekë, me të njëjtën vlerë, duke u bazuar në thelb në të njëjtat tri arsye që Paneli Shqyrtues i OSHP-së i kishte vlerësuar tashmë si të bazuara/të qëndrueshme: (i) mungesa e certifikatës/akreditimit personal të Menaxherit të Projektit nga DAK; (ii) mospranimi i certifikatave ISO (tani me

arsyetimin se “nuk rezultojnë të verifikueshme online”); dhe (iii) mungesa e pajisjeve teknike (kamioni special shpim dhe pajisja për matjen e integritetit të pilotave).

Përkatësisht, ne tani jemi eliminuar me arsyen e njëjtë sikurse në njoftimin mbi vendimin e datës 09.07.2026. Shih arsyet e eliminimit:

Gjatë rivlerësimit të tenderit, komisioni, në përputhje me autorizimet e LPP-së dhe Rregullores për Prokurimin Publik, ka konstatuar se OE, ku:

Menaxheri i Projektit – OE nuk ka certifikatën/dëshminë e kërkuar të akreditimit për personin e emëruar me vendim si Menaxher i Projektit, i cili, sipas DT-së, duhet të jetë inxhinier i gjeodezisë, me Licencë A dhe i certifikuar nga Departamenti i Akreditimit të Kosovës (DAK). Pra, Menaxherit i mungon certifikata nga DAK.

Certifikatat ISO – Dokumentet ISO të paraqitura nga OE nuk janë të verifikueshme online, ndonëse verifikueshmëria e tyre është përcaktuar si kërkesë në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë. Për rrjedhojë, nuk mund të konsiderohet e dëshmuar përmbushja e kësaj kërkese të kërkuar nga Autoriteti Kontraktues.

Mungesa e pajisjeve teknike të kërkuara – OE nuk ka dëshmuar posedimin/disponueshmërinë e pajisjeve për realizimin e kontratës, konkretisht:

Kamion special për shpim, minimum 6 tonë.

Pajisja për matjen dhe testimin e integritetit të pilotave.

Ky veprim i AK-së, ku përsëri na ka eliminuar me arsyetimin e njëjtë, përbën mosrespektim të drejtpërdrejtë të Vendimit të OSHP-së nr. 2026/0530, i cili është përfundimtar dhe detyrues për autoritetin kontraktues (neni 117 i LPP-së), pasi rivlerësimi është bërë në kundërshtim me urdhrin e Panelit Shqyrtues për t’iu përmbajtur dispozitave ligjore të LPP-së, duke përsëritur pikërisht ato arsye eliminimi që janë gjetur si të pabazuara. Ndryshimi formal i formulimit të arsyes së dytë (nga “certifikata të paqarta” në “nuk verifikohen online”) nuk përbën një rivlerësim të mirëfilltë dhe të pavarur, por vetëm një riformulim të së njëjtës përfundim tashmë të kundërshtuar nga OSHP-ja.

Duke mos kryer një rivlerësim të mirëfilltë dhe të pavarur, por duke përsëritur formalisht të njëjtin vendim eliminimi, AK-ja ka shkelur autoritetin dhe efektin detyrues të Vendimit të OSHP-së (neni 117 i LPP-së), duke rënë njëkohësisht në shkelje të rëndë sipas nenit 97.1 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, konkretisht paragrafëve:

d) – mosrespektim i parimeve themelore të prokurimit publik, përmes trajtimit jo të barabartë të OE ankues krahasuar me operatorin e rekomanduar për kontratë; dhe

e) – mosrespektim i rregullave për trajtimin e kërkesave për rishqyrtim/rivlerësim.

Për shkeljet e tilla të rënda, neni 99 i po kësaj Rregulloreje parasheh masa disiplinore ndaj zyrtarit/zyrtarëve përgjegjës të prokurimit, deri në revokim ose pezullim të certifikatës profesionale të prokurimit (neni 99.1–99.2).

Nëse eventualisht autoriteti kontraktues nuk do ta kthejë lëndën në rishqyrtim, pa dashur që një gjë e tillë të cilësohet si kërcënim, ne do të jemi të detyruar të kërkojmë nga OSHP-ja që ta

konstatojë këtë mosrespektim të Vendimit nr. 2026/0530 si shkelje të rëndë në kuptim të nenit 97.1 (d) dhe (e) të Rregullores Nr. 001/2022 dhe ta referojë rastin te KRPP-ja për shqyrtimin e përgjegjësisë disiplinore të zyrtarit/zyrtarëve të prokurimit të KUVENDIT KOMUNAL TË PRIZRENIT, të cilët kanë hartuar/nënshkruar Njoftimin B58 të datës.

Përkundër faktit që pretendimet tona ankimore janë aprovuar si të bazuara nga OSHP-ja, me Vendimin nr. 2026/0530 të datës, ne edhe njëherë po e sqarojmë se arsyet e AK-së për eliminimin tonë nga ky aktivitet i prokurimit janë të paqëndrueshme, për faktet si në vijim:

Sa i përket arsyes së parë të AK-së, ku është cekur se Menaxheri i Projektit i emëruar me vendim nuk posedon certifikatën e kërkuar sipas kërkesës së kapacitetit teknik dhe profesional, ky konstatim është i pabazuar dhe në kundërshtim me dokumentacionin e dorëzuar në ofertën tonë.

Në përputhje me kërkesën e dosjes së tenderit, ne kemi emëruar z. Fatmir Bajrami si Menaxher të Projektit, i cili i plotëson të gjitha kriteret e kërkuara, respektivisht është inxhinier i diplomuar i gjeologjisë, posedon përvojën e kërkuar profesionale, Licencën A, është i trajnuar për Siguri dhe Shëndet në Punë, si dhe është pjesë e personelit të laboratorit të akreditуar nga Drejtoria e Akreditimit e Kosovës (DAK).

Në ofertën tonë është dorëzuar Certifikata e Akreditimit e laboratorit "IMK BALLKAN PROJEKT" Sh.P.K., së bashku me dokumentacionin shoqërues të saj. Në pikën 6.2 "Personeli" të dokumentit të akreditimit figuron shprehimisht z. Fatmir Bajrami, M.Sc. i Gjeologjisë, si pjesë e personelit të laboratorit të vlerësuar nga DAK sipas standardit SK EN ISO/IEC 17025:2018. Dokumenti përfundon me konstatimin zyrtar se laboratori i plotëson kërkesat e pikës 6.2 të këtij standardi, duke konfirmuar se kompetenca e personelit është verifikuar gjatë procesit të akreditimit.

Kërkesa e dosjes nuk ka kërkuar paraqitjen e një certifikate individuale të akreditimit për Menaxherin e Projektit, pasi DAK nuk lëshon certifikata individuale për personelin, por akrediton laboratorin dhe, gjatë këtij procesi, vlerëson edhe kompetencën e personelit të tij. Pikërisht për këtë arsye, dokumentacioni zyrtar i akreditimit përmban listën e stafit të vlerësuar, ku figuron edhe z. Fatmir Bajrami.

Autoriteti kontraktues nuk ka identifikuar se cili dokument mungon apo cili kusht nuk është përmbushur nga z. Fatmir Bajrami, por është mjaftuar me konstatimin e përgjithshëm se ai nuk posedon certifikatën e kërkuar. Një arsyetim i tillë nuk është i bazuar në faktet e ofertës dhe nuk përmbush standardin e arsyetimit të vendimeve administrative. Përderisa ne kemi dorëzuar dokumentacionin që dëshmon se z. Fatmir Bajrami është pjesë e personelit të akreditуar nga DAK dhe i plotëson edhe të gjitha kërkesat e tjera të dosjes së tenderit, eliminimi ynë mbi këtë bazë është i pabazuar dhe nuk qëndron.

Autoriteti kontraktues e ka interpretuar në mënyrë të gabuar kërkesën e dosjes së tenderit, duke e trajtuar akreditimin e DAK-së si një certifikatë individuale të Menaxherit të Projektit. Në realitet, sipas sistemit të akreditimit të DAK-së dhe standardit SK EN ISO/IEC 17025:2018, akreditimi i jepet laboratorit, ndërsa kompetenca e personelit evidentohet në dokumentacionin zyrtar të akreditimit. Për rrjedhojë, dokumentacioni i dorëzuar nga operatori ynë e përmbush plotësisht kërkesën e dosjes së tenderit dhe nuk ekziston bazë ligjore për eliminimin e ofertës mbi këtë arsye.

Duhet sqaruar fakti se për OE-në e rekomanduar për kontratë rezulton se, për përmbushjen e kësaj kërkese, është pranuar vetëm një certifikatë e pjesëmarrjes në trajnim të organizuar nga Drejtoria e Akreditimit e Kosovës për standardin SK EN ISO/IEC 17025. Kjo certifikatë dëshmon vetëm ndjekjen e trajnimit dhe nuk përbën certifikatë akreditimi apo dëshmi se personi është vlerësuar dhe është kompetent sipas standardit në fjalë. Për rrjedhojë, nëse autoriteti kontraktues ka konsideruar se një certifikatë e pjesëmarrjes në trajnim është e mjaftueshme për përmbushjen e kësaj kërkese, atëherë nuk ka asnjë bazë ligjore që ne të eliminohemi nga aktiviteti i prokurimit, përderisa kemi dorëzuar dokumentacion edhe më të plotë dhe më bindës.

Theksojmë se kjo pikërisht ishte edhe konstatimi i Ekspertit Shqyrtues të OSHP-së në raportin nr. 2026/0530, i cili konstatoi se, sipas Ligjit Nr. 05/L-117 për Akreditim, DAK-u nuk parasheh akreditim personal për menaxherë projekti dhe se akreditimi i dhënë OE ankues, me komplet stafin dhe pajisjet e nevojshme, e plotëson këtë kriter, konstatim ky i mbështetur edhe nga Paneli Shqyrtues i OSHP-së, i cili e vlerësoi pretendimin tonë si të bazuar. AK-ja, duke përsëritur po të njëjtën arsye eliminimi, pa asnjë fakt apo dokument të ri, e ka shpërfillur hapur këtë konstatim tashmë të prerë të OSHP-së.

Autoriteti kontraktues, tek arsyeja e dytë për eliminimin tonë, ka dhënë arsyetimin se: "ISO Standardet i mungojnë (të paqarta dhe nuk i plotësojnë kushtet e kërkuara si në dosje të tenderit)."

Kjo arsye e eliminimit është e paqartë dhe e pabazuar, pasi ne kemi dorëzuar të gjitha certifikatat ISO të kërkuara në dosjen e tenderit, të cilat janë në përputhje të plotë me kërkesat e përcaktuara nga AK-ja.

Autoriteti kontraktues, në arsyetimin e tij për eliminimin tonë, nuk ka specifikuar se në çfarë konsiston pretendimi se certifikatat "mungojnë", janë "të paqarta" apo "nuk i plotësojnë kushtet e kërkuara", duke e bërë të pamundur identifikimin e ndonjë mangësie konkrete në dokumentacionin e dorëzuar.

Për më tepër, nëse autoriteti kontraktues ka pasur çfarëdo dileme lidhur me certifikatat e dorëzuara, ai ka mundur, në përputhje me nenin 59.2 dhe nenin 72 të Ligjit për Prokurimin Publik, të kërkojë sqarime nga ne si operator ekonomik ose të verifikojë drejtpërdrejt vlefshmërinë e tyre pranë kompanisë që i ka lëshuar këto certifikata. Duke mos i shfrytëzuar dispozitat ligjore dhe duke u mjaftuar me një konstatim të përgjithshëm e të paargumentuar, AK-ja ka nxjerrë një përfundim të pabazuar në gjendjen faktike dhe në dokumentacionin e dorëzuar nga ne dhe, njëkohësisht, na ka diskriminuar neve si OE i përgjegjshëm dhe me çmim më të lirë në këtë aktivitet të prokurimit.

Në njoftimin B58 të datës 08.09.2026, pas rivlerësimit të urdhëruar nga OSHP-ja, AK-ja e ka riformuluar arsyen e eliminimit, duke pretenduar tani se "dokumentet ISO të paraqitura nga OE nuk rezultojnë të verifikueshme online, ndonëse verifikueshmëria e tyre është përcaktuar si kërkesë në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë". Ky arsyetim i ri mbetet po aq i pabazuar, pasi vetë Eksperti Shqyrtues i OSHP-së, në raportin nr. 2026/0530, ka konstatuar shprehimisht se OE ka ofruar të gjitha certifikatat e kërkuara sipas pikave 9.1 dhe 9.2, kërkesa nr. 4, të Dosjes së Tenderit (ISO 9001:2015, ISO 14001:2015 dhe ISO 45001:2018), dhe se AK-ja duhet të veprojë në përputhje me nenet 59 dhe 72 të LPP-së, konstatim që Paneli Shqyrtues e ka vlerësuar si të qëndrueshëm.

AK-ja as tani nuk specifikon përmes cilit sistem apo databazë ka tentuar verifikimin dhe as nuk ka kërkuar sqarime shtesë nga ne, siç lejojnë/kërkojnë nenet 59.2 dhe 72 të LPP-së, para se të na eliminojë sërish mbi këtë bazë.

Autoriteti kontraktues na ka eliminuar, tek arsyeja e tretë, me arsyetimin: "Ju mungojnë pajisjet teknike sipas kërkesës 5 të kapacitetit teknik dhe profesional."

Ky arsyetim është i pabazuar dhe në kundërshtim me dokumentacionin e dorëzuar nga ne. Në përputhje me kërkesën 5 të Dosjes së Tenderit, ne kemi dorëzuar listën e mjeteve të punës, të nënshkruar, me dëshmitë të cilat janë kërkuar nga AK-ja, përmes të cilave vërtetohet fakti se pajisjet e prezantuara nga ana jonë janë në harmoni me të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit.

Për më tepër, nëse autoriteti kontraktues ka pasur ndonjë paqartësi ose dilemë lidhur me listën e pajisjeve të dorëzuara apo dokumentacionin përkatës, ai ka mundur, në përputhje me nenin 59.2 dhe nenin 72 të Ligjit për Prokurimin Publik, të kërkojë sqarime nga ana jonë përpara marrjes së vendimit për eliminim, por një veprim të tillë nuk e ka ndërmarrë, duke na diskriminuar neve si OE i përgjegjshëm me çmim më të lirë në këtë aktivitet të prokurimit.

Duke mos kërkuar sqarime dhe duke mos identifikuar konkretisht se cilat pajisje pretendohet se mungojnë, autoriteti kontraktues ka nxjerrë një përfundim të pabazuar, i cili nuk mbështetet në dokumentacionin e dorëzuar dhe nuk mund të përbëjë bazë ligjore për eliminimin tonë nga ky aktivitet i prokurimit.

Në njoftimin B58 të datës 08.09.2026, AK-ja tashmë e ka saktësuar këtë arsye, duke specifikuar se na mungojnë konkretisht: "Kamion special shpim, minimum 6 tonë" dhe "Pajisja për matjen dhe testimin e integritetit të pilotave". Edhe ky arsyetim i saktësuar mbetet i pabazuar, pasi vetë Eksperti Shqyrtues i OSHP-së, në raportin nr. 2026/0530, ka konstatuar shprehimisht se, ashtu siç janë kërkuar dëshmitë në dosjen e tenderit për listën e mjeteve të punës, OE ka ofruar listën e nënshkruar dhe të vulosur të pajisjeve të kërkuara, marrëveshje qiraje për mjetet që nuk i posedon në pronësi, libreza regjistrimi për mjetet e regjistrueshme, si dhe DUD-at doganorë apo faturat e shitblerjes, konstatim që Paneli Shqyrtues e ka vlerësuar si të qëndrueshëm. AK-ja nuk sqaron pse ky dokumentacion, tashmë i vlerësuar pozitivisht nga OSHP-ja, konsiderohet befas i pamjaftueshëm për këto dy pajisje specifike.

Prandaj, kur kemi parasysh faktet e lartcekura, kuptohet qartë se autoriteti kontraktues na ka eliminuar pa ndonjë bazë ligjore dhe në kundërshtim të plotë me kërkesat e dosjes së tenderit, vendimin e OSHP-së dhe dispozitat ligjore.

Ne, më datë 14.09.2026, kemi dorëzuar kërkesën për rishqyrtim, ndërsa po më këtë datë kemi pranuar edhe vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, ku AK-ja, siç duket, pa e analizuar fare kërkesën tonë, ka bërë refuzimin e saj pa e mbështetur në ndonjë dispozitë ligjore apo ndonjë fakt konkret që dëshmon të kundërtën e pretendimeve tona ankimore.

Vendimi i AK-së nuk paraqet fakt apo dokument të ri krahasuar me të dhënat në njoftimin B58 të datës 08.09.2026, të cilat tashmë janë vlerësuar dhe janë gjetur të pabazuara nga Paneli Shqyrtues i OSHP-së me Vendimin nr. 2026/0530. ZPP-ja e Komunës së Prizrenit, në cilësinë e organit që vendos mbi kërkesën për rishqyrtim, ka mbetur në të njëjtin qëndrim formal, duke mos u marrë në mënyrë të pavarur me pretendimet konkrete të parashtruara nga ne, çka përbën shkelje të drejtpërdrejtë të nenit 117 të LPP-së (efekti detyrues i vendimit të OSHP-së) dhe të

nenit 97.1 (d) dhe (e) të Rregullores Nr. 001/2022.

Sa i përket pretendimit tonë ankimor në lidhje me certifikatat ISO, vendimi i datës 14.09.2026 pranon shprehimisht se "Komisioni nuk ka arritur të bëjë verifikimin online të standardeve ISO". Ky formulim tregon qartazi se problemi nuk qëndron te dokumentacioni ynë, por te pamundësia/dështimi i vetë Komisionit të AK-së për të kryer verifikimin, rrethanë që nuk mund të na ngarkohet neve si operator ekonomik.

Certifikatat ISO 9001:2015, ISO 14001:2015 dhe ISO 45001:2018 janë lëshuar nga një organizëm certifikues i identifikueshëm, i cili mund të kontaktohet drejtpërdrejt për konfirmimin e vlefshmërisë së tyre. Autoriteti Kontraktues, në rast dyshimi ose pamundësie teknike për verifikim online, ka pasur në dispozicion – dhe sipas neneve 59.2 dhe 72 të LPP-së edhe detyrimin – që, para se të nxjerrë një vendim eliminues, të kërkojë sqarime shtesë nga ne si OE dhe/ose të verifikojë drejtpërdrejt vlefshmërinë e certifikatave pranë vetë organizmit certifikues që i ka lëshuar ato (p.sh. përmes email-it apo korrespondencës zyrtare me kompaninë certifikuese), veçanërisht kur sistemi online i vetë AK-së rezulton i pamjaftueshëm ose jofunksional për këtë qëllim.

AK-ja nuk ka ndërmarrë asnjërin nga këto veprime. As nuk specifikon nëpërmjet cilit sistem/databazë ka tentuar verifikimin, as nuk sqaron pse nuk është kontaktuar organizmi lëshues për konfirmim direkt, çka do të ishte mënyra më e drejtpërdrejtë, më e sigurt dhe më objektive për të shmangur çdo paqartësi. Kjo arsye e AK-së është e paqëndrueshme, aq më tepër kur vetë Eksperti Shqyrtues i OSHP-së, në raportin nr. 2026/0530, ka konstatuar shprehimisht se certifikatat e kërkuara janë ofruar në përputhje me pikat 9.1 dhe 9.2, kërkesa nr. 4, të Dosjes së Tenderit.

Sa i përket pretendimit tonë të dytë në lidhje me pajisjet teknike, AK-ja, në vendimin e saj, përsërit një konstatim të përgjithshëm ("pajisjet nuk janë paraqitur... nuk janë mbështetur me dëshmi"), pa e dëshmuar këtë pohim me dokumentacionin konkret të dorëzuar nga ne (lista e nënshkruar/vulosur e mjeteve, marrëveshjet e qirasë, librezat e regjistrimit, DUD-të/faturat), dokumentacion që vetë Eksperti Shqyrtues i OSHP-së e ka vlerësuar si të mjaftueshëm.

Mungesa e sqarimit mbi atë se cili dokument specifik konsiderohet i mangët, krahasuar me atë çka OSHP-ja tashmë e kishte gjetur të plotë, e bën këtë arsye të paqëndrueshme. Prandaj, arsyetimin e AK-së ne e shohim si tendencioz, me qëllimin që të mos rekomandohemi për kontratë ne si OE i përgjegjshëm dhe me çmim më të lirë.

Për korrektësi dhe për njoftim të OSHP-së, gjatë këtyre ditëve kemi pranuar një email njoftues nga kompania që ka lëshuar certifikatat tona, INVICTA ASSURANCE INTERNATIONAL (SHPK), përmes të cilit jemi njoftuar se kompania e mëparshme SIGMACERT DOO, me seli në Mal të Zi, ka zhvendosur selinë në Shqipëri dhe ka ndryshuar emrin e kompanisë në INVICTA ASSURANCE INTERNATIONAL (SHPK). Në njoftim është bërë e ditur se certifikata e akreditimit me numër IAS MSCB-136 është transferuar te kompania e re pa ndryshime, ndërsa numri i akreditimit dhe fusha e akreditimit kanë mbetur të njëjta.

Gjithashtu, jemi njoftuar se, për kompanitë, auditimet e mbikëqyrjes së të cilave janë të planifikuara pas datës së rinovimit, certifikatat do të rinovohen nën emrin INVICTA ASSURANCE INTERNATIONAL (SHPK). Për këtë arsye, nëse OSHP-ja e sheh të arsyeshme, për të hequr çdo paqartësi lidhur me autenticitetin, vlefshmërinë dhe statusin e certifikatave të dorëzuara nga ana jonë, mund të kontaktojë drejtpërdrejt kompaninë që i ka lëshuar certifikatat, e

cila mund të konfirmojë certifikatat në adresën zyrtare elektronike përkatëse.

Sa i përket pretendimit tonë të tretë në lidhje me Menaxherin e Projektit, AK-ja është arsyetuar se dëshmia "nuk është paraqitur fare", mirëpo një arsyetim i tillë është faktikisht i pasaktë, përderisa Certifikata e Akreditimit të laboratorit tonë nga DAK, e dorëzuar në ofertë, e përmban shprehimisht emrin Fatmir Bajrami në pikën 6.2 "Personeli", si pjesë e stafit të vlerësuar sipas standardit SK EN ISO/IEC 17025:2018, fakt ky i konstatuar dhe i pranuar tashmë nga vetë OSHP-ja në Vendimin nr. 2026/0530.

Nga ato që u thanë më lart, sqarojmë se vendimi i AK-së për refuzimin e kërkesës sonë për rishqyrtim nuk përbën një rivlerësim të mirëfilltë, të pavarur dhe në përputhje me urdhrin e OSHP-së, por një riafirmim formal të të njëjtit eliminim, tashmë të konstatuar si të pabazuar, të nxjerrë pa shfrytëzuar mjetet ligjore që LPP-ja i vë në dispozicion AK-së (nenet 59.2 dhe 72) për sqarimin e paqartësive drejtpërdrejt me palët e interesuara, përfshirë edhe rastin e ISO-s, si dhe me vetë organizmin lëshues të certifikatave.

Kur kemi parasysh të gjitha të lartcekurat, kuptohet qartë se AK-ja na ka diskriminuar që nga fillimi në këtë aktivitet të prokurimit, me qëllimin e vetëm që të favorizohet OE i rekomanduar për kontratë, ndërsa ne, si OE i përgjegjshëm dhe me çmim më të lirë, të eliminohemi nga aktiviteti i prokurimit, me arsye të cilat nuk janë të qëndrueshme dhe nuk mbështeten në dispozita ligjore.

Në këtë aktivitet të prokurimit nuk është bërë ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve në harmoni me nenin 59 të LPP-së, përkitazi me ofertën e OE-së të rekomanduar për kontratë dhe OE-ve të tjerë. Prandaj, ky aktivitet i prokurimit duhet të rishqyrtohet edhe njëherë, duke marrë parasysh të gjitha dëshmitë e ofruara.

Gjithashtu, nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënien e kontratës, që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët, siç parashihet edhe në nenin 60, paragrafi 1.1, të LPP-së, sepse nuk jemi rekomanduar për kontratë, edhe pse jemi OE i përgjegjshëm dhe me çmim më të lirë.

Në këtë aktivitet të prokurimit nuk është respektuar as neni 7 i LPP-së, sepse është favorizuar operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë, duke u rekomanduar për kontratë, ndërsa ne, edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të Njoftimit për Kontratë, nuk jemi shpallur fitues të këtij tenderi.

Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë se: "Autoriteti kontraktues do t'i trajtojë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente."

Po ashtu, paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që, gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë që (vi) tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse. Mirëpo, në këtë rast, AK-ja nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore, sepse ne, edhe pse i plotësojmë të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit, nuk jemi rekomanduar për kontratë.

Gjithashtu, nuk është marrë në konsideratë as neni 1 i LPP-së, pasi dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike, si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve

kontraktuese në Kosovë.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim:

Operatori ekonomik "IMK BALLKAN PROJEKT" SH.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim sipas nenit 108/A të LPP-së. Në formularin e kërkesës, OE pretendon shkelje të neneve 1, 6, 7, 59, 60, 69 dhe 72 të LPP-së, nenit 40 dhe nenit 97.1 të Rregullores Nr. 001/2022, si dhe i referohet Vendimit të Panelit Shqyrtues nr. 2026/0530.

Pas rishqyrtimit të dosjes së aktivitetit, ofertës së OE-së, kërkesave të përcaktuara paraprakisht në Njoftimin për Kontratë/Dosjen e Tenderit dhe rezultateve të verifikimit të dokumentacionit, Autoriteti Kontraktues vlerëson se pretendimet nuk e ndryshojnë rezultatin e vlerësimit.

Neni 59.4 i LPP-së përcakton parimin themelor se një tender konsiderohet i përgjegjshëm vetëm kur është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit. Devijimet mund të tolerohen vetëm kur janë të vogla dhe nuk ndryshojnë materialisht kushtet ose kërkesat e tenderit.

Neni 69 i LPP-së i jep të drejtë Autoritetit Kontraktues të kërkojë dëshmi për kualifikimet minimale teknike dhe/ose profesionale të specifikuara në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë. Rrjedhimisht, kur një dëshmi është përcaktuar si kërkesë e kualifikimit, OE duhet ta dëshmojë përmbushjen e saj në mënyrën e kërkuar.

Neni 40.2 i Rregullores Nr. 001/2022 përcakton se tenderët ekzaminohen, vlerësohen dhe krahasohen sipas procedurave dhe kritereve të përcaktuara në Njoftimin për Kontratë/Dosjen e Tenderit dhe se AK nuk mund ti ndryshojë, modifikojë ose heqë kërkesat e përcaktuara paraprakisht.

Sipas nenit 40.6 të Rregullores, tenderi është i përgjegjshëm vetëm nëse është në pajtueshmëri administrative me kërkesat formale, në pajtueshmëri teknike me kërkesat dhe specifikimet dhe është dorëzuar nga një OE që përmbush kriteret e përzgjedhjes.

Në Dosjen e Tenderit/Njoftimin për Kontratë është kërkuar shprehimisht që standardet/certifikatat ISO të jenë të verifikueshme online. Gjatë rivlerësimit, Komisioni nuk ka arritur të bëjë verifikimin online të standardeve ISO të paraqitura nga OE në mënyrën e kërkuar në dokumentet e tenderit.

Kjo kërkesë nuk mund të anashkalohet gjatë vlerësimit, sepse do të nënkuptonte heqje ose zbutje të një kushti të publikuar paraprakisht vetëm për një ofertues, në kundërshtim me nenin 40.2 të Rregullores dhe me parimin e trajtimit të barabartë. Për këtë arsye, pretendimi i OE-së se oferta duhej të konsiderohej e përgjegjshme pavarësisht pamundësisë së verifikimit online, refuzohet si i pabazuar.

Nga kontrolli i listës së pajisjeve dhe dokumenteve dëshmuese të dorëzuara rezulton se pajisjet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues nuk janë paraqitur në listën e OE-së dhe, njëkohësisht, nuk janë mbështetur me dëshmi të pronësisë, posedimit apo marrjes në shfrytëzim sipas kërkesave të Dosjes së Tenderit. Mungesa prek drejtpërdrejt aftësinë teknike/profesionale të kërkuar për realizimin e kontratës dhe nuk paraqet vetëm mangësi formale.

Në kuptim të nenit 69 të LPP-së dhe nenit 40.6(c) të Rregullores, OE duhet të dëshmojë se i plotëson kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara paraprakisht. Pranimi i një oferte pa pajisjet e

kërkuara dhe pa dëshmitë përkatëse do të ishte në kundërshtim me kriteret e publikuara dhe me detyrimin e AK-së për vlerësim të njëjtë për të gjithë tenderuesit.

Dosja e Tenderit ka kërkuar specifikisht dëshminë/certifikatën për Menaxherin e Projektit, sipas kërkesës së përcaktuar nga AK lidhur me certifikimin/akreditimin nga DAK. Nga dokumentacioni i tenderit të OE-së është konstatuar se kjo dëshmi e kërkuar nuk është paraqitur fare.

Pasi kjo kërkesë është pjesë e kritereve të përcaktuara paraprakisht për kapacitetin teknik dhe profesional, AK nuk mund ta konsiderojë të përmbushur pa dëshminë përkatëse. Kjo mbështetet në nenin 69 të LPP-së dhe nenet 40.2 dhe 40.6 të Rregullores.

Duke marrë parasysh se mospërmbushja e secilës prej kërkesave të mësipërme është e mjaftueshme për të cenuar përgjegjshmërinë/kualifikimin e tenderit, ndërsa në rastin konkret janë konstatuar disa mangësi kumulative, Autoriteti Kontraktues vlerëson se nuk ekziston bazë ligjore për ndryshimin e rezultatit të vlerësimit. Për këto arsye, kërkesa për rishqyrtim refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 28.09.2026. ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2026/0732 ndërsa me datë 29.09.2026 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2026/0732, me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është përgjigjur rekomandimet e raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE është pajtuar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtresat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e"IMK BALLKAN PROJEKT" SH.P.K.eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2026/0732 ka vlerësuar si në vijim:

PRETENDIMET e Operatorit Ekonomik: Kanë të bëjë me Kërkesën nr 2. të kapacitetit teknik dhe profesional, me çështjen e akreditimit të Kompanisë, gjegjësisht akreditimin personal të menaxherit të projektit, e që sipas AK me dëshmitë e ofruara nuk është plotësuar ky kriter, eliminimin e OE ankues për shkak të mos plotësimit të standardeve ISO, sipas AK, dhe Autoriteti kontraktues na ka eliminuar tek arsyeja e trete me arsyetimin: OE ankues nuk ka Kamiona special për shpim, dhe pajisja për testimin e integritetit të “pilotave”!. Këto pretendime

kanë qenë të njëjta edhe në Ankesën e Shqyrtuare e cila është subjekt i Vendimit nr 2026/0530 të OSHP-së.

Përgjigje e AK në pretendimet ankimore të OE ankues:

Me 14.09.2026 AK e Refuzon ankesën e OE të së njëjtës datë me arsyetimin se: Autoriteti Kontraktues vlerëson se pretendimet nuk e ndryshojnë rezultatin e vlerësimit.

Konstatimet e Ekspertit Shqyrtues për pretendimet e OE: Edhe një herë eksperti Shqyrtues konstaton se OE ankues i ka plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit, dhe gjatë rivlerësimit përveç pretendimeve jo të sakta të AK se OE ankues nuk Kamion special për shpim, dhe pajisje për matjen dhe testimin e integritetit të "pilotave", nuk ka paraqitur asnjë gjetje të re në rivlerësim. Në fakt OE ankues i ka këto dy pajisje.

Lidhur me këto pretendime të OE ankues, AK është dashtë të respektojë Vendimin e Panelit Shqyrtues të OSHP-së nr 2026/0530 të datës 28.08.2026 ku janë aprovuar këto pretendime nga Paneli Shyrtues, ose t`i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, rrjedhimisht ka bërë shkelje të nenit 117 të LPP dhe të nenit 97.1 të rregullores nr.001/2022. Sa i përket cilësimit të OE për referim të rastit në KRPP për shkelje disiplinore rreth mos zbatim të Vendimit të OSHP-së, i mbetet panelit Shqyrtues një vendimmarrje eventuale.

Eksperti Shqyrtues konstaton se këto pretendime të OE ankues janë të qëndrueshme.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues pas rivleresimit ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Shqyrtimet laboratorike per projektet e investive kapitale- projekt tre vjeqar" me nr. të prokurimit: "622-26-1534-2-1-1"

Paneli Shqyrtues, administroi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë aktet dhe veprimet e AK, parashtresat dhe provat e ankuesit dhe raportin e ekspertit shqyrtues dhe duke i analizuar të gjitha ato në kontekstin e përgjithshëm të kësaj çështje ka krijuar bindjen e pavarur e tij/saj, se ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar. Në ketë rast Paneli shpjegon se raporti i ekspertizës është hartuar në mënyrë te përgjithësuar keshtu duke mos i trajtuar te gjithë dokumentacionin bashkëlidhur ofertës te OE ankues por i gjithë arsyetimi eshte fokusuar vetëm ne nje dokument te posaqem ne kete rast listën e pajisjeve teknike, si rrjedhojë, PSH nuk e mbështet rekomandimin e ekspertit shqyrtues i cili ka rekomanduar se AK edhe me tutje t'a kthej aktivitetin ne rivlerësim.

Paneli Shqyrtues nuk e mbështet në tërësi qëndrimin e ekspertit shqyrtues, i cili ka rekomanduar t'a kthej aktivitetin ne rivlerësim, pa pasur mbeshtje te dokumenteve ne veçanti ato qe lidhen me pajisjet teknike. Një raport i tillë është dhënë pa një analizë të mirëfilltë të pretendimeve mbi te cilat eshte eliminuar OE ankues dhe të kontestuara ne kete rast, dmth pa vlerësuar ndërlidhjen e tyre me kërkesat e parashtruara ne DT si dhe pa marrë parasysh nevojat konkrete të AK.

Sa i përket pretendimeve ankimore të operatorit ekonomik ankues, të cilat lidhen me eliminimin e tij nga ky aktivitet i prokurimit ne rastet e meparshme te gjykuara (2026/0530) eliminimi I ketij operatori ekonomik ka qene ne forme te pergjithsuar p, me kete rast edhe Paneli ka mbeshtetur raportin e ekspertit shqyrtues ndersa Paneli Shqyrtues konstaton se, gjatë shqyrtimit

të kësaj ankese, do të fokusohet në pretendimin ankimor percaktues lidhur me mos plotesimn e pajisjve teknike sipas kerkesave ne DT, me çrast OE ankues pretendon se është eliminuar padrejtësisht. Ky pretendim përbën çështjen thelbësore që ndikon drejtpërdrejt në vendimmarrjen përfundimtare të Panelit Shqyrtues.

Për këtë arsye, Paneli Shqyrtues nuk e sheh të nevojshme të trajtojë më tej pretendimet e tjera që lidhen me OE ankues në fjalë, pasi në këtë fazë është bërë i qartë pozicioni dhe klasifikimi përfundimtar i OE ankues në kuadër të këtij aktiviteti te prokurimit.

Paneli e konsideron këtë pretendim si vendimtar për zgjidhjen e çështjes, perderisa edhe eksperti shqyrtues ka konstatuar se OE ka plotesuar listen mirepo i njejti raport nuk ka ofruar sqarime lidhur me pajisjet teknike qe nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në DT , me kete rast PSH pas shqyrtimit të dokumentacionit teknik të dorëzuar nga OE ankues, konstaton se pajisja e prezantuar nga OE ankues nuk dëshmon përmbushjen e kërkesës së përcaktuar në DT, përkatësisht kërkesës për posedimin e një kamioni special për shpim me kapacitet minimal prej 6 tonësh. Kjo për faktin se në dokumentacionin teknik të pajisjes së ofruar është specifikuar se pesha bruto është 3,000 kg, ndërsa pesha neto po ashtu është 3,000 kg, rrjedhimisht vlera e deklaruar është dukshëm nën minimumin e kërkuar nga Autoriteti Kontraktues. Paneli vlerëson se, ndonëse pajisja e ofruar mund të ketë destinim dhe funksion për kryerjen e punimeve të shpimit, përmbushja e funksionit të njëjtë nuk nënkupton automatikisht përmbushjen e specifikimeve teknike të kërkuara. Në këtë rast, OE ankues është dashur të dëshmojë jo vetëm se posedon pajisje që kryen punime shpimi, por edhe se ajo përmbush parametrin minimal të përcaktuar nga AK.Rrjedhimisht, PSH vlerëson se pajisja e ofruar nuk mund të konsiderohet e barasvlershme me kërkesën e AK-së vetëm mbi bazën e destinimit të saj për shpim, përderisa dokumentacioni teknik i paraqitur nuk dëshmon përmbushjen e kapacitetit minimal të kërkuar.

Andaj, në bazë të vlerësimit dhe bindjes së Panelit shqyrtues dhe duke u bazuar edhe në dispozita ligjore dhe nënligjore për prokurim publik, ankuesi ka dështuar që ofertën e tij ta plotësoj konform kërkesave të DT, Rrjedhimisht, Paneli Shqyrtues konstaton se pretendimi ankimor eshte i pabazuar

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të miratohet vetëm si pjesërisht e bazuar mirëpo Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull Shqyrtimet laboratorike per projektet e investive kapitale- projekt tre vjeqar” me nr. të prokurimit: "622-26-1534-2-1-1" duhet të mbetet në fuqi, pasi që nuk ekzistojnë argumente të mjaftueshme ligjore për të urdhëruar AK që të kthej aktivitetin e prokurimit në rivlerësim, për arsyet e elaboruara si më sipër në këtë vendim.

- Përfundim –

Bazuar në kompetencat e OSHP të parapara me nenin 105, lidhur me nenin 106 të LPP, Paneli Shqyrtues vuri në zbatim mes tjerash dhe nenin 103 të Ligjit të cituar sipas të cilit të gjitha palët e interesuara do të kenë qasje të barabartë në procedurat për shqyrtimin e prokurimit dhe në mjetet juridike dhe se, asnjë vendim i OSHP, nuk do të merret ose bëhet në mënyrën me të cilën diskriminohet në të mirë ose në dëm të një pjesëmarrësi në procedurë ose të një personi ose ndërmarrje tjetër.

Paneli sqaron se përveç nenit 1,7,27,28 dhe 59 të Ligjit për Prokurim Publik, është e rëndësishme të theksohet se të gjithë ofertuesit janë të vetëdijshëm për procesin e aplikimit dhe dorëzimit të dokumentacionit në përputhje me dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë. Kanë përvojë të mjaftueshme në këtë fushë dhe janë pjesëmarrës të vazhdueshëm nëpër tendere që publikohen në Republikën e Kosovës, duke kontribuar në një aplikim të ndershëm dhe të drejtë për të gjithë.

Kjo siguron një garë të barabartë dhe të drejtë për të gjithë ofertuesit dhe shmang ndikimin në prolongimin e procedurave të prokurimit, me "kërkesa për sqarime të vazhdueshme nga ofertuesit" për dokumentacionet të cilat vazhdimisht i procedojnë për aplikime në ofertat e tyre. Andaj, paneli sqaron se në këtë rast përgjegjësia bie mbi ofertuesin, i cili tenderon për të fituar. Sepse është evidente dhe e njohur për të gjithë, se në çdo rast të njoftimit për kontratë, secili ofertues do duhej që në fazën paraprake (para ofertimit), ti kundërshtoj të njëjtat apo eventualisht të parashtrojë pyetje apo të kërkojë sqarime nga AK. Në këtë kontekst edhe sipas gjykimit të pavarur të këtij paneli, AK por as OE, nuk duhet të thirren në dispozita nënligjore që të kërkojë sqarime shtesë për dokumentacionin e ofertuesve në çdo rast, pasi siç u sqarua si më sipër të gjithë ofertuesit janë të vetëdijshëm për detyrimet dhe procedurat e aplikimit nëpër tenderë.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me padi mund t'i drejtohet Gjykatës Administrative në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm për anulim të vendimit në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**
- OE - **"IMK BALLKAN PROJEKT" SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: